



TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

- Emri i NSH-së:** Ndërmarrja Shoqërore për Mirëmbajtjen e Automjeteve
NSHMA“Dukagjiniremont (Ndërmarrja)
- Emri i Ndërmarrjes së Re:** Ndërmarrja e Re Auto Servisi “Dukagjiniremont” SH.P.K.
 (“Ndërmarrja e Re”)
- Vendndodhja:** Komuna e Pejës
- Biznesi/Sektori:** Mirëmbajtja e Automjeteve
- Shërbimet:** Ndërmarrja ka bërë mirëmbajtjen dhe kontrollin teknik të makinave të ndryshme.
- Tregu:** Me poziten e vet atraktive në zonën industriale, afër rrugës magjistrale Pejë-Prishtinë dhe stacionit të trenit dhe e rrethuar me NSH-të që janë privatizuar tanimë, e bënë “Dukagjiniremont”-in shumë joshës për investitorët potencial që janë të interesuar t’i bashkohen kësaj zone industriale me perspektivë të lartë dhe emër të njohur.
- Konkurrenca:** Në këtë zonë nuk ka ndonjë konkurrencë të vërtetë që mund të ndikoj tek Ndërmarrja e Re Auto Servisi“Dukagjiniremont” Nuk ka punëtori në këtë zonë që mirren me mirëmbajtjen e makinave, që kanë kapacitet të i bëjnë konkurrencë Ndërmarrjes së Re Auto Servisi“Dukagjiniremont” për shkak të pozitës dhe hapësirës që kjo Ndërmarrje e Re ka.
- Punonjësit:** Asnjë punëtor i NSH nuk punon në Ndërmarrjen e Re të ofertuar.
- Ndërtesat dhe tokat:** Ndërmarrja e Re e propozuar përfshin objektet dhe tokën me sipërfaqe totale prej 11,500 m² dhe është e regjistruar në emër të P.SH “Industrije Naftë Trgovina”- Pejë.
Zyra Rajonale e AKP-së është duke punuar nga afër me Drejtorit relevante në Komunën e Pejës si dhe është në kontakt më përfaqësues të Ndërmarrjes INA në Zagreb për të gjetur mundësin e bartjes së kësaj prone në emër të Ndërmarrjes Shoqërore “Dukagjiniremont”.
Vërejtje : UNMIK-u që nga fillimi i misionit të tij në Qershor 1999, ka okupuar objektet dhe tokën e kësaj ndërmarrje kurse tani është okupuar nga misioni EULEX.
- Përshkrimi i objekteve:
1. Holli kryesor për riparimin e makinave të udhëtarëve, ndërtuar me 1972. Lartësia 5,50 m e ndërtuar nga çimentoja dhe armatura me strukturë çeliku si dhe me çati prej xhami. Në brendi të hollit është një “kat” me zyre të menaxhmentit. Holli kryesor është i pajisur me të gjitha instalimet.
 2. Objekti për shërbime të shpejta dhe kontroll teknike ndërtuar me 1979. Lartësia nga 6.00 m deri 4.50 m. Strukturë çimentoje me armaturë.
 3. Objekti për riparimin e mjeteve të mëdha, ndërtuar me 1979. Lartësia 5.5 m. strukturë çeliku.

4. Dhoma e zdrukthëtarisë me kazan për ngrohje dhe pjesën me motor si dhe dhomën ndihmëse ndërtuar me 1979. Lartësia 3.5m. strukturë çimentoje me armaturë.
5. Kabina e punëtorit të sigurimit fizik ndërtuar në vitin 1972 me çimento dhe çelik.

Përshkrimi i tokës:

1. Sipërfaqja tokësore me gjithë kompleksin ka patur rrethojë teli të thurur me shtylla betoni dhe portë hekuri. Në këtë sipërfaqe tokësore janë dy ndërtime nga betoni që janë përdorur për larje dhe lubrifikim të veturave. Sipërfaqja tokësore është e betonuar.

Vërejtje:

Përshkrimet e lartpërmendura bazohen në raportin të bërë nga "Ekonomik Biro" – Biro e Inxhinjeringut nga Beogradi kryer në Shtator 1992.

Gjithashtu, gjatë tërë këtyre viteve UNMIK-u dhe pastaj edhe EULEX-i kanë bërë një varg investimesh brenda dhe jashtë objekteve, mirëpo Zyra Rajonale e AKP-së nuk posedon informata të sakta mbi investimet e bëra si dhe gjendjen momentale të objekteve.

Detyrimet që do të barten:

- 1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- 2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- 3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

Imazh i Ndërmarrjes së Re:



Informatat:

Departamenti i Shitjes
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255
Fax: + 381 (0) 38 248 076



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

www.pak-ks.org

**Dokumentet e
Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Ilir Konushevci Nr.8
10000 Pristinë, Kosovë